



Çfarë do të thotë për ju vendimi për shpallje si i huaj i padëshiruar?

Ju keni marrë një shpallje i padëshirueshëm nga zyra e imigracionit dhe naturalizimit (IND). Në vendimin që keni marrë tregon përse ju jeni shpallur i huaj i padëshiruar. Në këtë broshurë shpjegohet se çfarë është shpallja i padëshiruar dhe çfarë do të thotë kjo për ju.

1. Çfarë është një shpallje i padëshiruar?
2. Sa zgjatë shpallja i padëshiruar?
3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në një sistem informacioni?
4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga E&S ose SIS?
5. Çfarë ndodh nëse ju prap se prap do jeni në Holandë?
6. Çfarë mund të bëni nëse nuk pajtoheni me shpalljen i padëshiruar?
7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?
8. Si të kërkonti shfuqizimin (e përkohshëm) e shpalljes i padëshiruar?
9. Çfarë duhet ju të bëni nëse keni pyetje?

1. Çfarë është një shpallje i padëshiruar?

Një shpallje i padëshiruar thotë se ju jeni i padëshiruar në Holandë. Ju do të merrni një shpallje i padëshiruar nëse IND vendos që ju jeni një rrezik për Holandën. Është një masë ndaj personave që zakonisht kanë kryer një vepër penale. Shpesh bëhet fjalë për një krim. Ju duhet të largoheni menjëherë nga Holanda për shkak të shpalljes si i padëshiruar. Pas kësaj ju nuk mund të hyni më në Holandë. Ju do të sinjalizoheni për shpalljen i padëshiruar në një sistem informacioni. Lexoni në pyetjen 3 se çfarë është sinjalizimi.

2. Sa zgjatë shpallja i padëshiruar?

Shpallja e padëshirueshëm nuk ka datë përfundimi dhe përfundon vetëm atëherë kur IND vendos ta bëjë këtë. Kjo është e mundur nëse ju kërkonti shfuqizimin e shpalljes i padëshiruar. Pyetja 8 shpjegon se si të kërkohet shfuqizimi.

3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në një sistem informacioni

Ju do të sinjalizoheni për shpalljen i padëshiruar. Të jesh i sinjalizuar ose sinjalizimi do të thotë që autoritetet e vendosin emrin tuaj në sistemin e informacionit. Policia dhe policët kufitar të shtetit shohin përmes sinjalizimit tuaj në sistemin e informacionit se ju jeni një i huaj i padëshiruar. Në vendim tregohet se në cilin sistem do të sinjalizoheni.

Ka dy sisteme:

- Executie & Signalering (E&S): Ky është një sistem informacioni i policisë Holandeze dhe policisë ushtarake Mbretërore.
- Sistemi i informacionit Shengen (SIS): Është një sistem European ku policët kufitarë dhe policia e shteteve të Shengenit mund të shikojnë. Ju mund të lexoni se cilat shtete (vende) janë shtete (vende) Shengen në www.ind.nl/schengengebied ose www.ind.nl/schengenarea.

Ju mund të sinjalizoheni vetëm në 1 sistem.

4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga E&S ose SIS?

Nëse ju keni kërkuar shfuqizimin e përhershëm për shpalljen si i padëshiruar dhe kjo kërkesë u është miratuar.

5. Çfarë ndodh nëse ju jeni prap se prap në Hoandë?

Qëndrimi në Holandë është i dënueshëm. Ju mund të merrni një dënim me burg deri në 6 muaj maksimalisht ose një gjobë prej disa mijra euro. Kjo ceket në nenin 197 të Kodit Penal.

6. Çfarë mund të bëni nëse nuk jeni i pajtimit me shpalljen si i padëshiruar?

Ju mund të bëni një ankimim tek IND. Në vendimin që keni marrë tregohet se si mund ta bëni këtë.

7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?

Nëse IN DE shfuqizon shpalljen tuaj si i padëshiruar. Kjo mundet të ndodhë vetëm nëse ju e kërkonit atë dhe nëse IND miraton kërkesën tuaj. Në situata shumë të veçanta dhe urgjente mund të kërkonit shfuqizimin e përkohshëm të shpalljes suaj i padëshiruar.

8. Si të kërkonit shfuqizimin (e përkohshëm) të shpalljes i padëshiruar?

Ju mund të kërkonit shfuqizimin e shpalljes si i padëshiruar. Në situata tejet të veçanta dhe urgjente mundeni të kërkonit shfuqizimin e përkohshëm. Për të bërë kërkesën e shfuqizimit mund të përdorni formularin e kërkesës për të shfuqizuar një shpallje i padëshiruar, ndalimit të hyrjes ose vendimit për sinjalizim (9004 of 9504) në faqen e internetit për këtë qëllim, të plotësoni dhe të e dërgoni në IND.

Gjithashtu dikush tjetër mund të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj. Ju duhet të i jepni atij personi lejen zyrtare për të ndërrmarrë veprime në emrin tuaj. Ju e vendosni këtë në letër me nënshkrimin tuaj. Kjo quhet një autorizim.

9. Çfarë duhet të bëni ju nëse keni pyetje?

- Vizitoni faqen tonë të internetit në www.ind.nl/ongewenstverklaring ose www.ind.nl/en/undesirability.
- Telefononi linjën e informacionit të IND në +31 88 043 04 30. Ky numër mund të arrihet nga e hëna deri të premten nga ora 09.00 deri në ora 17.00.

Asnjë e drejtë nuk mund të rrjedhë nga përmbajtja e publikimit. Nëse përkthimi çon në dallime në interpretim, versioni Holandez do të mbizotërojë. Teksti nga ky botim mund të përdoret me kusht që të përmendet burimi.